

# TË DREJTAT LIGJORE TË PUNËTORËVE TË RESTORANTEVE

Ligji amerikan i punësimit shpesh mund të jetë i ndërlikuar dhe hutues, veçanërisht për emigrantët e sapoardhur. Shpesh herë, informacioni nuk afishohet në vendin e punës dhe është vështirë që ta gesh në internet. Çdo punëtor (me apo pa dokumente) ka të drejtën që të paguhet drejtësisht për çdo orë që ka punuar, si dhe për orët plus pas orarit. Po çfarë do të thotë “drejtësisht”? Dhe si mund ta dallosh nëse pronari është duke ju shfrytëzuar? Nëse punoni në një restorant, duhet ta dini që ka ligje në këtë vend, të cilat ju mbrojnë dhe ne e kemi sjellë këtë artikull që t’ju ndihmojmë për të kuptuar të drejtat tuaja.



**Pyetje: E di që ka një ligj për pagesën minimale mirëpo duke qenë se punoj si kamarierë punëdhënësi im thotë se ai nuk zbatohet në rastin tim. A ka një pagesë minimale për punëtorët që marrin bakshishe (tips)?**

**Përgjigje:** Rroga minimale federale është \$7,25 në orë. Ky ligj përjashton të punësuarit që marrin bakshishe. Mirëpo, punëtorët me bakshishe në shtetin e New York-ut mund të marrin ligjërisht 5,50 dollarë në orë nëse kjo shumë plus bakshishet jep në total një shumë e cila është të paktën e barabartë me 7,25 dollarë në orë (dhe punëtorët i mbajnë për vete të gjithë bakshishet). Nëse bakshishet bashkë me rrogën prej të paktën \$5,50 në orë, përsëri nuk nxjerrin shumën e barabartë me \$7,25 në orë, atëhere punëdhënësi duhet t’ju paguajë diferencën.

**Pyetje: Më kanë thënë se duhet të ndaj bakshishet me punëtorët e tjerë. Duke qenë se bakshishet më takojnë mua, a duhet t’i ndaj ato?**

**Përgjigje:** Të ndash bakshishet (tipet) me punëtorët e tjerë njihet si “tip pooling” (bashkim bakshishesh) apo “tipping out” (dhënie bakshishi). Duke qenë se bakshishet u përkasin punëtorëve të cilët “u shërbejnë klientëve” dhe nganjëherë të njëjtit klient përveç kamarierit i shërbejnë më shumë se një punëtor (si për shembull “bussers” - basërs), punëdhënësi juaj mund t’ju kërkojë që të ndani bakshishet me ta. Megjithatë, të ndash bakshishet me supervizorët apo me menaxherët është e paligjshme. Është gjithashtu e detyrueshme që marrëveshja e kërkuar për bashkim të bakshisheve (“tip pooling”) të jetë e arsyeshme. “E arsyeshme” do të thotë që nëse ju jeni kamarierë, mund të jepni rreth 15 deri në 20% të bakshisheve tuaja. Mirëpo, nëse ju detyrojnë që të jepni fjala vjen 60% të bakshisheve tuaja, atëhere ka mundësi që kjo marrëveshje të ketë shkelur ligjin.

**Pyetje: Punoj në një restorant dhe marr një rrogë fikse \$350 në javë, pavarësisht se sa orë punoj më shumë 40-orëshi i javës. Punëdhënësi im thotë se nuk më takon pagesë shtesë për jashtë orarit. A është e ligjshme kjo?**

**Përgjigje:** Jo, nuk është e ligjshme, sepse edhe nëse punëdhënësi juaj gëzon të drejtën që t’ju paguajë një rrogë fikse, ai përsëri nuk lejohet që të mos ju paguajë shtesë për punën pas orarit, ngaqë ka zgjedhur këtë mënyrë pagese. Pothuajse të gjithë punëtorët që punojnë më shumë se 40 orë në ditë gjatë një jave duhet të paguhet për secilën nga orët shtesë sipas formulës së “pas orarit” (“overtime”) – e cila është pagesa normale që shumëzohet një herë e gjysëm (ka pak raste përjashtimesh). Kështu, nëqoftëse rroga juaj është \$350 në javë për 40 orë, atëhere ju jeni duke u paguar me \$8,75 në orë dhe pagesa për punën tuaj pas orarit duhet të jetë \$13,13 në orë.

**Pyetje: A ka të drejtë punëdhënësi që të më kërkojë të vesh një uniformë?**

**Përgjigje:** Po. Megjithatë, kostoja për blerjen dhe/apo mirëmbajtjen e uniformës nuk duhet të jetë e tillë sa ta ulë rrogën tuaj poshtë rrogës minimale. Nëse punëtorët që paguhet me rrogë minimale duhet të veshin uniformë, atëhere u takon punëdhënësve të tyre që t’i lajnë dhe mirëmbajnë ose të paguajnë punëtorët për ta bërë këtë. Veshjet e zakonshme (si pantallona të zeza dhe këmbë të bardhë) zakonisht nuk konsiderohen “uniforma”.

**Pyetje: Sa orë mundet punëdhënësi t’i kërkojë punëtorit që të punojë?**

**Përgjigje:** Nuk ka kufizime në numrin e orëve të punës në ditë që mund të punoni, (përveç fëmijëve nën moshën 18 vjeç). Po kështu, nuk ka kufizime sesa herët në mëngjes, apo deri sa vonë natën mund të punojë një i rritur i punësuar. Megjithatë, për shembull, në industrinë e restoranteve, punëtori duhet të pushojë të paktën 24 orë për çdo javë kalendarike.

**Pyetje: Punëdhënësi im më detyron të paguaj nga xhepi për gjëra si gota dhe pjata që thyhen, apo për klientë që porosisin ushqim por nuk vijnë për ta marrë në restorant. A është e ligjshme kjo?**

**Përgjigje:** Jo. Punëdhënësi juaj është duke shkelur ligjin. I vetmi rast që një punëdhënësi mund të bëjë zbritje nga rroga juaj, është atëhere kur ju shprehimisht e autorizoni me shkrim që ta bëjë këtë dhe zbritja është për përfitimin tuaj, si për pagesa të çmimeve mujore të sigurisë shëndetësore, përfitime pensioni, shëndeti apo asistence sociale, si edhe për pagesa për anëtarësinë dhe vlerësime të sindikatës tuaj të punës.

**Avokati Lloyd Ambinder ka 20 vjet që mbron të drejtat e punëtorëve. Nëse jeni aktualisht i punësuar dhe janë duke ju shfrytëzuar, ju japim zemër që të kontaktoni zyrën tonë për një konsultim falas për të drejtat tuaja. Të gjitha diskutimet janë të privileguara dhe mbajtja e tyre sekret është e garantuar.**

**VIRGINIA & AMBINDER, LLP**

111 Broadway, Suite 1403, New York, N.Y. 10006

Tel: (212) 943-9080 • www.vandallp.com

Orët e punës: Nga e hëna deri të premten 8 a.m. – 7 p.m.

Takime edhe në mbrëmje dhe në fundjavë